



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:002716

Datë: 15.05.2023

Numri i dokumentit: 04278211

C.nr.02/2021

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual me Sekretaren juridike Azemine Berisha, në çështjen juridiko-civile të paditësve M. K. nga Kaçaniku, V. R. nga fshati ...ë dhe F. B. nga fshati ... Hani i Elezit, të cilit me autorizim i përfaqëson avokati A. I. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimit "... " me seli në Prishtinë, për çështjen kontestuese kompensimi i demit, jashtë seancës gjyqësore me datën 15.05.2023. mori dhe në të njëjtën ditë bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I. **NDËRPRITET** procedura në këtë çështje kontestimore, sipas padisë së paditësve, M. K. nga Kaçaniku, V. R. nga fshati ... dhe F. B. nga fshati ... Hani i Elezit, e ushtruar më datën 08.01.2021, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "... ", me seli në Prishtinë, për çështjen kontestuese kompensimi i demit, për shkak të fillimit të procedurës së falimentimit.

II. Pala paditëse udhëzohet që kërkesën e tij t'ia paraqesë komisionit të likuidimit tek e paditura – Likuidatori KS "...", me seli në Prishtinë.

III. Gjykata konstaton se pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore, me rastin e padisë, ndërsa shpenzimet tjera të krijuara secila palë i përballon shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësit për mes të autorizuarit ës me datën 08.01.2021, në Gjykatën Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë. Me të cilën ka kërkuara kompensimin e dëmit jo material dhe material për shkak të lëndimeve të cilat i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata pas pranimi të njoftimit dhe vendimit numër 70-24/2021, të datës 24.09.2021, ka gjetur se ndaj të paditurës ka filluar procedura e falimentimit. Me qenëse ndaj të paditurës ka filluar procedura e falimentimit gjykata e ka ndërprere procedurën kontestimore në këtë çështje. Gjykata e ka ndërprere procedurën sepse me nenin 277 pika (d) të LPK-së, është paraparë se kur të fillojë procedura e falimentimit atëherë duhet të ndërprehet procedura kontestimore për shkak të fillimit të falimentimit.

Gjykata sa i perkat shpenzimeve të procedurës, vendosi si në pikën dy të dispozitivit të aktvendimit, duke u bazuar në rezultatin e procedurës konform nenit 452,2 të LPK-së

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega Kaçanik

C.nr.02/2021 prej datës 12.05.2023

Gjyqtari:

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi, të këtij aktvendimi përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.

Dërguar me datën 15.05.2023

Të autorizuarës së paditësve 1x1

Të paditurës 1x1